



British Embassy  
Pristina



**Memorandum Mirëkuptimi  
në mes të  
Komunës se Prishtinës  
dhe  
EC Ma Ndryshe  
dhe  
Ambasadës Britanike në Prishtinë**

Komuna e Prishtinës dhe EC Ma Ndryshe, janë pajtuar që të fillojnë bashkëpunimin për projektin e titulluar “Transparenca online e komunës së Prishtinës” më tutje: “Projekti”, me përkrahje të Ambasadës Britanike në Prishtinë.

1. Detajet janë të rregulluara me Marrëveshjen Llogaridhënëse për Grant për Projektin dhe qëllimin e bashkëpunimit teknik, të cilat janë të parashtruara në “Projekt”, të bashkëngitura me këtë marrëveshje.
2. Projekti do të zbatohet nga EC Ma Ndryshe, organizatë jo-qeveritare me seli në Prizren, Komuna e Prizrenit, Rr. Saraqët 5, dhe në Prishtinë, Komuna e Prishtinës, Rr. Perandori Dioklician 14 (katë V).
3. Komuna e Prishtinës dhe EC Ma Ndryshe, përmes këtij Memorandumi të Mirëkuptimit të garantuara nga Ambasada Britanike në Prishtinë, zotohen në marrjen e këtyre obligimeve

**Obligimet e Komunës së Prishtinës**

Komuna e Prishtinës, respektivisht Kryetari i Komunës dhe ekzekutivi (drejtoritë komunale) për zbatim sa më efektiv të projektit, zotohen se:

- Do të jenë partnerë strategjik në zbatimin e projektit, duke vepruar në transparencë të plotë dhe bashkëpunim të ngushtë me organizatën monitoruese,
- Monitoruesve dhe stafit të organizatës do t'u ofrojnë qasje të papenguar në të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike,
- Monitoruesve dhe stafit të organizatës do t'u ofrojnë qasje fizike në hapësirat e administratës komunale,
- Monitoruesve dhe stafit të organizatës do t'u ofrojnë qasje të papenguar në takimet e hapura të organeve të komunës (takimet e Kryetarit me drejtorët, Komitetet e Kuvendit të Komunës, seancat plenare të Kuvendit të Komunës, etj.)

**Obligimet e EC Ma Ndryshe**

EC Ma Ndryshe do t'i zbatojë të gjitha aktivitetet e specifikuara në “Projekt”. EC Ma Ndryshe do të monitorojë punën e organeve komunale në Prishtinë, me fokus të veçantë në degën e ekzekutivit (Kryetari i komunës dhe drejtorët). EC Ma Ndryshe për zbatim sa më efektiv të projektit, zotohet se:

- Do ta realizojë monitorimin e komunës me standarde të larta profesionale dhe hulumtuese, të bazuara në fakte



British Embassy  
Pristina



- Do të sigurojë dialog të përhershëm me organet dhe zyrtarët komunalë për të gjitha çështjet e monitoruara (hulumtuara), dhe do të gjejnë zgjidhje të përbashkët,
  - Do të ofrojë mbështetje teknike dhe profesionale për sektorin e urbanizmit në Komunën e Prishtinës,
  - Do të sigurojë edhe mendimin e zyrtarëve përkatës komunalë në lidhje me çështjet e monitoruara, para se ato të publikohen në media,
  - Të gjitha të gjeturat e monitorimit do t'i përkthejë edhe në gjuhët rekomanduese me qëllim të përmirësimit të performancës qeverisëse në Prishtinë.
4. Faza e parë e projektit do të zbatohet në periudhën 1 Nëntor 2013 – 31 Mars 2014. Të gjitha palët do të konsiderojnë vazhdimin e këtij projekti në fazën e fundit të zbatimit të tij.
5. Nëse ndodh ndonjë ndryshim që sipas mendimit të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ose Komunës së Prishtinës dëmtojnë ndjeshëm vlerën e projektit, palët paraprakisht do të konsultohen për masat për ta zgjidhur problemin dhe të pajtohen për veprimet e mëtejme. Në rast të ndryshimeve përbajtjesore, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar rezervon të drejtën për ta përfunduar kontributin e saj në këtë Projekt.
6. Të gjitha korrespondencat lidhur me këtë Memorandum dhe projektin do t'i drejtohen: zyrtarit të caktuar nga komuna e Prishtinës; Hajrulla Çeku, Drejtor Ekzekutiv, EC Ma Ndryshe në koordinim me Miranda Shala, Zyrtare për Projekte, Ambasada Britanike Prishtine.
7. Nëse pikat e lartpërmendura dhe në Marrëveshja Llogaridhënëse për Grant dhe Projekti të bashkangjitura janë të pranueshme për Komunën e Prishtinës dhe EC Ma Ndryshe. Ky Memorandum do ta konsiderojë marrëveshjen të konfirmuar të palëve nënshkruese mbi këtë çështje.

Për Komunën e Prishtinës

Shpend Ahmeti  
Kryetar

Për EC Ma Ndryshe

Hajrulla Çeku  
Drejtor ekzekutiv

Konfirmuar nga:  
Për Ambasadën Britanike

Ian Cliff  
Ambasador

Prishtinë, mars 2014